

Lista e Përkufizimeve në Shqip

Arranged Alphabetically

1. “Arkivim elektronik” është një shërbim që siguron marrjen, ruajtjen, rikthimin dhe fshirjen e të dhënave elektronike dhe dokumenteve elektronike, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria dhe lexueshmëria e tyre, si dhe të ruhet integriteti, konfidencialiteti dhe vërtetimi i origjinës gjatë gjithë periudhës së ruajtjes.
2. “Atribut” është një karakteristikë, cilësi, e drejtë ose leje të një personi fizik ose juridik ose të një objekti.
3. “Autentifikim” është një proces elektronik, që mundëson konfirmimin e identifikimit elektronik të një personi fizik ose juridik ose konfirmimin e origjinës dhe integritetit të të dhënave në formë elektronike.
4. “Autentifikim i fortë i përdoruesit” është një autentifikim i bazuar në përdorimin e të paktën dy faktorëve autentifikimi nga kategori të ndryshme, si njohuria, diçka që vetëm përdoruesi e di, posedimi, diçka që vetëm përdoruesi e zotëron ose qenësia, diçka që përdoruesi është, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra, në mënyrë që shkelja e njërit nuk cenon besueshmërinë e të tjerëve dhe është projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë konfidencialitetin e të dhënave të autentifikimit.
5. “Autoritet” është autoriteti përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fushës së identifikimit elektronik, shërbimeve të besuara dhe portofolit të identitetit digjital, i krijuar me ligjin nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.
6. “Autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike” është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, organi publik përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, në vijim Autoriteti.
7. “Burim autentik” është një hapësirë në memorie (repository) ose sistem, i mbajtur nën përgjegjësinë e një organi të sektorit publik ose subjektit privat, që mban dhe ofrontribute për një person fizik ose person juridik apo objekt dhe që konsiderohet të jetë burimi kryesor i atij informacioni ose i njohur si autentik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi ose legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe praktikën administrative.
8. “CERT” është Ekipi i Përgjigjes ndaj Emergjencave të Sigurisë Kibernetike pranë Autoritetit.
9. “Certifikatë e kualifikuar për autentifikim faqesh interneti” është një certifikatë për autentifikim faqesh interneti, e cila është lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 55 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
10. “Certifikatë e kualifikuar për nënshkrim elektronik” është një certifikatë për nënshkrim elektronik, që është lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 34 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
11. “Certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike” është një certifikatë për vulë elektronike, që është lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 46 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
12. “Certifikatë e sigurisë kibernetike” është një dokument i lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike, që vërteton se një produkt, shërbim ose proces TIK është vlerësuar për pajtueshmërinë me kërkesat specifike të sigurisë, të përcaktuara në skemën e certifikimit të sigurisë kibernetike.
13. “Certifikatë për autentifikim faqesh interneti” është një vërtetim elektronik, i cili bën të mundur autentifikimin e një faqeje interneti dhe lidh faqen e internetit me personin fizik apo juridik, të cilit i është lëshuar kjo certifikatë.
14. “Certifikatë për nënshkrim elektronik” është një vërtetim elektronik, që lidh të dhënat e verifikimit të nënshkrimit elektronik me një person fizik dhe konfirmon të paktën emrin ose pseudonimin e atij personi.
15. “Certifikatë për vulë elektronike” është një vërtetim elektronik, që lidh të dhëna të vërtetimit të vlefshmërisë së vulës elektronike me një person juridik dhe konfirmon emrin e këtij personi.
16. “CSIRT Kombëtar” është Ekipi i Përgjigjes ndaj Incidenteve të Sigurisë Kibernetike pranë Autoritetit.

17. "CSIRT pranë operatorëve" është ekipi i përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, pranë operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.
18. "CSIRT qeveritar" është CSIRT-i sektorial, i cili menaxhon të gjitha infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit për sektorin qeveritar.
19. "CSIRT sektorial" është personi apo ekipi i përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike për sektorin përkatës, sipas përcaktimeve në anekset e ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", i vendosur pranë një operatori që administron infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të informacionit ose institucionit përgjegjës të linjës.
20. "Dokument elektronik" është çdo përmbajtje e ruajtur në formë elektronike, në veçanti në formë teksti ose zëri, regjistrim vizual ose audiovizual.
21. "Emergjencë e sigurisë kibernetike" është situata gjatë së cilës siguria e informacionit në sistemet e informacionit ose siguria e rrjeteve të komunikimeve elektronike është cenuar duke vënë në rrezik interesin publik të Republikës së Shqipërisë.
22. "ENISA" është Agjencia për Sigurinë Kibernetike e Bashkimit Evropian.
23. "Grupi Evropian i Identitetit Digjital" është një organ i krijuar nga rregullorja (BE) nr.2024/1183 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 11 prill 2024, për të mbështetur dhe për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për shërbimet e besuara, portofolat e identitetit digjital dhe skemat e identifikimit elektronik midis shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
24. "Grupi i bashkëpunimit" është një organ i krijuar nga direktiva (BE) nr. 2022/2555 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 14 dhjetor 2022, me qëllimin për të mbështetur e lehtësuar bashkëpunimin strategjik dhe shkëmbimin e informacionit midis shteteve anëtare të BE-së.
25. "Hapësirë kibernetike" është mjedisi digjital i aftë të krijojë, të procesojë dhe të shkëmbejë komunikimin elektronik të informacionit të krijuar nga rrjetet dhe sistemet e informacionit edhe pa qenë të lidhur në internet.
26. "Identifikim elektronik" është procesi i përdorimit të të dhënave identifikuese të personit, në formë elektronike, që përfaqësojnë në mënyrë unike një person fizik ose juridik apo një person fizik, që përfaqëson një person tjetër fizik ose një person juridik.
27. "Incident i sigurisë kibernetike" është çdo ngjarje që komprometon disponueshmërinë, vërtetësinë, integritetin, konfidencialitetin e të dhënave të ruajtura, të transmetuara apo të përpunuara ose të shërbimeve të ofruara apo të aksesueshme përmes rrjeteve dhe sistemeve të informacionit.
28. "Infrastrukturë e besuar" është tërësia e mekanizmave organizativë, që ndihmojnë në krijimin, ruajtjen, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e besueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve të besuara, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
29. "Infrastrukturë e rëndësishme e informacionit" është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit të zotëruara nga një autoritet publik ose privat, i cili nuk është pjesë e infrastrukturës kritike të informacionit, por që mund të rrezikojë apo të kufizojë ofrimin e shërbimit dhe vazhdimësinë e punës, në rastin e cenimit të sigurisë së informacionit.
30. "Infrastrukturë kritike e informacionit" është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, të zotëruara nga një autoritet publik ose privat, që ofrojnë shërbime, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.
31. "Kërcënim kibernetik" është një ngjarje ose veprim i mundshëm, që mund të dëmtojë, të ndërpresë ose të ndikojë negativisht në rrjetet e sistemet e informacionit për përdoruesit e tyre dhe persona të tjerë.
32. "Kontrollues i aksesit (gatekeeper)" është një sipërmarrje, e cila ofron shërbime të platformave bërthamë dhe plotëson kriteret e mëposhtme: a) ka një ndikim të rëndësishëm në tregun e brendshëm; b) ofron një shërbim të platformës bërthamë, që është një portë e rëndësishme për përdoruesit e biznesit për të arritur te përdoruesit fundorë; c) mban një pozicion të pandryshueshëm dhe të qëndrueshëm në operacionet e tij ose është e parashikueshme që do të mbajë një pozicion të tillë në të ardhmen e afërt.
33. "Krijuesi i një vule elektronike" është një person juridik, i cili krijon një vulë elektronike.

34. "Krizë kibernetike" është situata gjatë së cilës siguria e informacionit në sistemet e informacionit ose siguria e rrjeteve të komunikimeve elektronike është seriozisht e rrezikuar, duke vënë në rrezik interesin publik të Republikës së Shqipërisë.
35. "Log-e" është mesazh apo e dhënë mbi ngjarje lidhur me sigurinë kibernetike.
36. "Marka e besuar e portofolit të identitetit digjital" është një tregues i verifikueshëm, i thjeshtë dhe i dallueshëm, i cili komunikon në mënyrë të qartë se portofoli i identitetit digjital është siguruar në përputhje me përcaktimet e bëra në ligji nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
37. "Masat e sigurisë kibernetike" janë tërësia e veprimeve për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmëria e besueshmëria e shërbimeve të rrjeteve të komunikimit në hapësirën kibernetike.
38. "Mjete të identifikimit elektronik" janë njësi materiale ose jomateriale, që përmbajnë të dhënat e identifikimit personal ose karakteristikat që së bashku formojnë identifikuesit, të cilat mundësojnë autentifikimin në një shërbim online ose, aty ku është e mundur, offline.
39. "Modaliteti offline" është një ndërveprim ndërmjet një përdoruesi dhe një pale të tretë në një vendndodhje fizike, duke përdorur teknologji që përpunojnë në afërsi, ku portofolit të identitetit digjital nuk i kërkohet të aksesojë sistemet në distancë nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik, për qëllime të ndërveprimit.
40. "Motor kërkimi në internet" është një shërbim digjital që lejon përdoruesit të vendosin pyetje për të kryer kërkime në parim në të gjitha faqet e internetit ose në të gjitha faqet e internetit në një gjuhë të caktuar, në bazë të një pyetjeje për çdo temë në formën e një fjalëkyçi, kërkese zanore, fraze ose hyrjeje tjetër dhe rezultatet e kthimit në çdo format në të cilin mund të gjenden informacionet në lidhje me përmbajtjen e kërkuar.
41. "Nënshkrim elektronik" janë të gjitha të dhënat në formë elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, dhe që përdoren nga nënshkruesi për të nënshkruar.
42. "Nënshkrimet elektronike të avancuara" janë nënshkrimet elektronike, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
43. "Nënshkrimet elektronike të kualifikuara" janë nënshkrimet elektronike të avancuara, të cilat janë krijuar nga pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar dhe që mbështeten në një certifikatë të kualifikuar për nënshkrimet elektronike.
44. "Nënshkrues" është një person fizik, i cili krijon një nënshkrim elektronik.
45. "Ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar" është një ofrues i shërbimit të besuar, që ofron një apo më shumë shërbime të besuara të kualifikuara, të cilit i është dhënë statusi i kualifikuar nga Autoriteti.
46. "Ofrues i menaxhuar i shërbimit të sigurisë" është një ofrues shërbimi të menaxhuar, që kryen ose ofron ndihmë për aktivitetet në lidhje me menaxhimin e rrezikut të sigurisë kibernetike.
47. "Ofrues i shërbimit të besuar" është personi fizik ose juridik, publik ose privat, i cili ofron një ose më shumë shërbime të besuara, si ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar ose si ofrues jo i kualifikuar i shërbimit të besuar.
48. "Ofrues i shërbimit të menaxhuar" është një ent që ofron shërbime në lidhje me instalimin, menaxhimin, funksionimin ose mirëmbajtjen e produkteve të TIK-ut, rrjeteve, infrastrukturës, aplikacioneve ose çdo rrjeti dhe sistemet e tjera të informacionit, nëpërmjet asistencës ose administrimit aktiv të kryer ose në ambientet e klientëve, ose në distancë.
49. "Ofruesi i shërbimit DNS" është një ent, i cili ofron: a) shërbimet rekursive të zgjidhjes së emrave të domenit të disponueshëm publikisht për përdoruesit fundorë të internetit; b) shërbime autoritative për zgjidhjen e emrave të domain-it për përdorim nga palët e treta, me përjashtim të serverave të emrave rrënjë.
50. "Operator i infrastrukturës kritike të informacionit" është çdo person fizik ose juridik, i cili administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

51. "Operator i infrastrukturës së rëndësishme të informacionit" është çdo person fizik ose juridik, i cili administron infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".
52. "Organ i sektorit publik" është autoriteti shtetëror, në nivel qendror, rajonal ose vendor, shoqatat e krijuara nga një ose disa prej këtyre autoriteteve, si dhe entitetet private të autorizuar për të ofruar një shërbim publik elektronik në kuptim të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
53. "Organe të rregulluara nga e drejta publike" janë organet që përmbushin karakteristikat e mëposhtme: a) janë themeluar për qëllimin specifik të përmbushjes së nevojave në interes të përgjithshëm, pa karakter industrial ose tregtar; b) kanë personalitet juridik; c) financohen, në pjesën më të madhe, nga shteti, autoritetet rajonale ose lokale apo ose nga organe të tjera, të rregulluara nga e drejta publike, ose i nënshtrohen mbikëqyrjes së menaxhimit nga këto autoritete apo organe, ose kanë një bord administrativ, menaxherial ose mbikëqyrës, më shumë se gjysma e anëtarëve të të cilit emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose lokale apo nga organe të tjera, të rregulluara nga e drejta publike.
54. "Organe të vlerësimit të konformitetit" janë organet kompetente, të cilat kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin, të akredituara sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin, i cili kryen vlerësimet e konformitetit të veprimtarisë së një ofruesi të kualifikuar të shërbimit të besuar ose shërbimeve të besuara të ofruara prej tij ose certifikimin e portofolit të identitetit digjital apo të mjeteve të identifikimit elektronik.
55. "Organe të vlerësimit të konformitetit për sigurinë kibernetike" janë personat juridikë kombëtarë ose ndërkombëtarë, të akredituar nga institucioni përgjegjës për akreditimin për të kryer vlerësimet dhe konformitetin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve që lidhen me sigurinë kibernetike në TIK, si dhe vlerësimin e masave të sigurisë kibernetike të implementuara nga infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit.
56. "Organizatë kërkimore" është një subjekt që ka si qëllim parësor të kryejë kërkime zhvillimi të aplikuara ose eksperimentale me synimin për të shfrytëzuar rezultatet e atij kërkimi për qëllime komerciale, por që nuk përfshijnë institucionet arsimore.
57. "Pajisje e krijimit të vulës elektronike" është produkt software ose hardware, i konfiguruar për këtë qëllim, i cili përdoret për të krijuar një vulë elektronike.
58. "Pajisje e krijimit të vulës elektronike të kualifikuar në distancë" është një pajisje për krijimin e vulës elektronike, që menaxhohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital", në emër të një krijuesi të vulës.
59. "Pajisje të krijimit të nënshkrimit elektronik" janë produkte hardware dhe software, të konfiguruar për këtë qëllim, për të krijuar një nënshkrim elektronik.
60. "Pajisje të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar" është një pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik, që plotëson kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 35 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
61. "Pajisje të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar në distancë" është një pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar, që menaxhohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital", në emër të një nënshkruesi.
62. "Pajisje të krijimit të vulës elektronike të kualifikuar" është mjet i krijimit të vulës elektronike, i cili plotëson, për aq sa është e mundur, kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 35 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
63. "Palë e përfshirë" është një person fizik ose juridik, që mbështetet në identifikimin elektronik, portofolat e identitetit digjital ose mjete të tjera identifikimi elektronik apo në një shërbim të besuar.
64. "Përdorues" është një person fizik ose juridik apo një person fizik, që përfaqëson një person tjetër fizik ose një person juridik, që përdor shërbime të besuara apo mjete të identifikimit elektronik të ofruara në përputhje me ligji nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".

65. "Përdorues biznesi" është çdo person fizik ose juridik, që vepron në kapacitet tregtar ose profesional, duke përdorur shërbimet e platformave bërthamë për qëllimin e ofrimit ose gjatë ofrimit të mallrave dhe shërbimeve për përdoruesit fundorë.
66. "Përmbajtje të dëmshme për fëmijën", sipas ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
67. "Përputhja e identitetit" është një proces, ku të dhënat e identifikimit të personit ose mjetet elektronike të identifikimit përputhen ose lidhen me një llogari ekzistuese, që i përket të njëjtit person.
68. "Pika e shkëmbimit të internetit" (internet exchange point) është një infrastrukturë rrjeti, që lejon ndërlidhjen e më shumë se dy sistemeve autonome të pavarura, kryesisht për të lehtësuar shkëmbimin e trafikut të internetit, siguron ndërlidhje vetëm me sistemet autonome, si dhe nuk kërkon që trafiku i internetit që kalon midis dy sistemeve autonome pjesëmarrëse të kalojë përmes një sistemi të tretë autonom dhe nuk cenon ose ndërhyt në një trafik të tillë.
69. "Platformë e shërbimeve të rrjeteve sociale" është një platformë që u mundëson përdoruesve fundorë të lidhen, të ndajnë, të zbulojnë dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet pajisjeve të shumta, veçanërisht përmes bisedave, postimeve, videove dhe rekomandimeve.
70. "Playbooks" është një udhërrëfyes, i cili tregon një procedurë të mirëpërcaktuar që duhet të ndiqet për menaxhimin e çdo kategorie incidenti të sigurisë kibernetike.
71. "Portofoli i identitetit digjital" (në vijim portofoli) është një mjet identifikimi elektronik, që i lejon përdoruesit të ruajë, të menaxhojë dhe të vërtetojë në mënyrë të sigurt të dhënat e identifikimit të personit dhe vërtetimeve elektronike të atributëve, me qëllim ofrimin e tyre palëve të përfshira dhe përdoruesve të tjerë të portofolave të identitetit digjital dhe të nënshkruajë me anë të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose të vulosë me anë të vulave elektronike të kualifikuara.
72. "Procese TIK" janë një grup aktivitesh që kryejnë projektimin, zhvillimin, ofrimin ose mirëmbajtjen e një produkti ose shërbimi TIK.
73. "Produkt" janë hardware ose software apo komponentët përkatës të hardware-it ose softwareit, të cilët përdoren për ofrimin e shërbimeve të besuara dhe identifikimin elektronik.
74. "Produkt TIK" është një element ose një grup elementesh të një rrjeti ose sistemi informacioni.
75. "Qëndrueshmëria kibernetike" është aftësia e sistemeve të informacionit për të mbrojtur të dhënat nga sulmet kibernetike, si dhe aftësia për të rifilluar funksionimin normal të punës brenda një kohe, e cila nuk ndikon në veprimtarinë e operatorit të infrastrukturës kritike ose të rëndësishme të informacionit në rast të një sulmi kibernetik.
76. "Regjistër elektronik" është një sekuençë e regjistrimeve elektronike të të dhënave, që siguron integritetin dhe saktësinë e renditjes kronologjike të këtyre regjistrimeve.
77. "Regjistër elektronik i kualifikuar" është një regjistër elektronik, i cili ofrohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 67 të ligjit nr. 51/2026 "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital".
78. "Regjistri i emrave të domain-eve me nivel të lartë.al" ose "regjistri i emrave të domain-eve TLD.al" është regjistri me emrat e domain-eve të internetit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë me prapashtesën ".al", që administrohet nga autoriteti përgjegjës për komunikimet elektronike dhe postare, i cili harton, miraton dhe aplikon një rregullore të veçantë për këtë qëllim. Regjistri përfshin emrat e domain-eve (dhe nëndomain-eve) ccTLD.al, të dhënat e poseduesve të tyre, historikun e veprimeve me domain-et me .al dhe sistemin teknik ccTLD.al, i cili përfshin funksionimin e serverave dhe pajisjeve të tjera të nevojshme, mirëmbajtjen e bazave të të dhënave dhe shpërndarjen e skedarëve të zonës TLD për të bërë të mundur aksesimin e emrave të domain-eve me .al në internet etj., të cilat përfshihen në rregulloren e sipërpërmendur.
79. "Regjistrim i të dhënave" janë të dhënat elektronike të regjistruara së bashku me metadatat përkatëse, që mbështesin përpunimin e të dhënave.
80. "Rrezik i sigurisë kibernetike" është një ngjarje e identifikueshme me efekt të mundshëm negativ për sigurinë e rrjeteve e të sistemeve të informacionit.
81. "Rrjet dhe sistem i informacionit", është: a) një rrjet i komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për komunikimet elektronike në fuqi; b) çdo pajisje ose grup i pajisjeve të lidhura ose të ndërlidhura dhe një ose disa prej tyre kryejnë përpunimin automatik të të dhënave digjitale nëpërmjet një programi; c) të dhënat digjitale të ruajtura, të përpunuara, të marra ose të

transmetuara nga elemente të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, për funksionimin, përdorimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

82. “Rrjet i komunikimeve publike elektronike” është i njëjtë me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike.
83. “Rrjet i shpërndarjes së përmbajtjes” është një rrjet serverash të shpërndarë gjeografikisht, me qëllim sigurimin e disponueshmërisë, aksesueshmërisë ose shpërndarjes së shpejtë të përmbajtjes dhe shërbimeve digjitale për përdoruesit e internetit në emër të përmbajtjes dhe ofruesve të shërbimeve.
84. “Rrjeti Evropian i Organizatave Ndërlidhëse të Krizave Kibernetike (EU-CyCLONe)” është rrjeti i krijuar nga direktiva (BE) nr. 2022/2555 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 14 dhjetor 2022, me qëllimin për të mbështetur koordinimin e menaxhimit të incidenteve dhe krizave të sigurisë kibernetike në shkallë të gjerë në nivel operacional dhe për të siguruar shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të BE-së.
85. “Rrjeti i CSIRT-eve” është rrjeti i krijuar nga direktiva (BE) nr. 2022/2555 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 14 dhjetor 2022, i përbërë nga CSIRT-et kombëtare të shteteve anëtare të BE-së me qëllimin promovimin e bashkëpunimit operacional të shpejtë dhe efektiv midis tyre.
86. “Shërbim i arkivimit elektronik të kualifikuar” nënkupton një shërbim arkivimi elektronik, i cili ofrohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
87. “Shërbim i besuar” është shërbimi elektronik i ofruar me pagesë, i cili konsiston në: a) lëshimin e certifikatave për nënshkrimet elektronike, certifikatat për vulat elektronike, certifikatat për autentifikimin e faqes së internetit ose certifikatat për ofrimin e shërbimeve të tjera të besuara; b) vërtetimin e vlefshmërisë së certifikatave për nënshkrimet elektronike, certifikatat për vulat elektronike, certifikatat për autentifikimin e faqes së internetit ose certifikatat për ofrimin e shërbimeve të tjera të besuara; c) krijimin e nënshkrimeve elektronike ose vulave elektronike; ç) vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike ose vulave elektronike; d) ruajtjen e nënshkrimeve elektronike, vulave elektronike, certifikatave për nënshkrime elektronike ose certifikatave për vula elektronike; dh) menaxhimin e pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike në distancë (remote) ose pajisjeve të krijimit të vulave elektronike në distancë; e) lëshimin e vërtetimeve elektronike të atributive; ë) vërtetimin e vlefshmërisë së vërtetimit elektronik të atributive; f) krijimin e vulave kohore elektronike; g) vërtetimin e vlefshmërisë së vulave kohore elektronike; gj) ofrimin e shërbimeve të transmetimit elektronik të regjistruar; h) vërtetimin e të dhënave të transmetuara nëpërmjet shërbimeve të transmetimit elektronik të regjistruar dhe dëshmimeve përkatëse; i) arkivimin elektronik të të dhënave elektronike dhe të dokumenteve elektronike; j) regjistrimin e të dhënave elektronike në një regjistër elektronik.
88. “Shërbim i besuar i kualifikuar” është një shërbim i besuar, i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në ligji nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
89. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është i njëjtë me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike.
90. “Shërbim i transmetimit elektronik të kualifikuar të regjistruar” është një shërbim i transmetimit elektronik të regjistruar, ofrimi i të cilit plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 54 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
91. “Shërbim i transmetimit elektronik të regjistruar” është një shërbim që bën të mundur transmetimin e të dhënave midis palëve të treta nëpërmjet mjeteve elektronike dhe siguron provën në lidhje me trajtimin e të dhënave të transmetuara, duke përfshirë dëshmi për dërgimin dhe marrjen e të dhënave dhe që mbron të dhënat e transmetuara kundër rrezikut të humbjes, vjedhjes, dëmtimit apo çdo ndryshimi tjetër të paautorizuar.
92. “Shërbim TIK” është një shërbim që konsiston plotësisht ose kryesisht në transmetimin, ruajtjen, marrjen ose përpunimin e informacionit me anë të rrjetit dhe sistemeve të informacionit.
93. “Shërbimet cloud computing” është një shërbim digjital që mundëson administrimin sipas kërkesës dhe akses të gjerë në distancë në një grup të shkallëzueshëm dhe elastik të burimeve kompjuterike të ndashme, duke përfshirë vendin, ku burimet e tilla shpërndahen në disa lokacione.

94. "Shërbimet e platformave bërthamë" janë shërbimet si më poshtë: a) të ndërmjetësimit në internet; b) motorët e kërkimit në internet; c) të rrjeteve sociale në internet; ç) të platformave të ndarjes së videove; d) të komunikimeve ndërpersonale të pavarura nga numri; dh) operative; e) shfletuesit e internetit; ë) asistentët virtualë; f) cloud computing; g) të reklamimit në internet, duke përfshirë çdo rrjet reklamimi, shkëmbim reklamimi ose çdo shërbim tjetër ndërmjetësimi reklamimi të mundësuar nga një ndërmarrje që ofron ndonjë nga shërbimet e platformave bërthamë, të përmendura në shkronjat "a" deri "f" të kësaj pike.
95. "Shërbimi digjital" është çdo shërbim i shoqërisë së informacionit, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për tregtinë elektronike.
96. "Shërbimi i qendrës së të dhënave" është një shërbim që përfshin struktura ose grupe strukturash, të dedikuara për të centralizuar akomodimin, ndërlidhjen dhe funksionimin e teknologjisë së informacionit dhe pajisjeve të rrjetit që ofrojnë ruajtjen, përpunimin e të dhënave dhe shërbimet e transportit së bashku me të gjitha objektet dhe infrastrukturat për shpërndarjen e energjisë dhe kontrollin mjedisor.
97. "Siguria e rrjetit dhe sistemeve të informacionit" është aftësia e rrjetit dhe e sistemeve të informacionit për t'i rezistuar në një nivel të caktuar sigurie çdo veprimi, që komprometon disponueshmërinë, vërtetësinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave të ruajtura, të transmetuara ose të përpunuara dhe shërbimeve përkatëse të ofruara përmes këtij rrjeti ose sistemeve të informacionit.
98. "Siguria kibernetike" është tërësia e veprimeve të nevojshme për të mbrojtur rrjetet dhe sistemet e informacionit, përdoruesit e këtyre rrjeteve dhe sistemeve, si dhe personat e tjerë të prekur nga kërcënimet kibernetike.
99. "Sistemi i emrave të domain-eve (DNS)" është një sistem që në mënyrë hierarkike shpërndan emërtime dhe mundëson identifikimin e shërbimeve dhe burimeve të internetit, duke lejuar pajisjet e përdoruesit fundor të përdorin shërbimin e rrugëzimit dhe lidhjes në internet për të arritur ato shërbime dhe burime.
100. "Skanim proaktiv" është kryerja e një ose disa veprimeve paraprake të avancuara, që bëjnë të mundur identifikimin, zbulimin dhe memorizimin e rreziqeve me ndikim të konsiderueshëm përpara shfaqjes së tyre.
101. "Skema e certifikimit të sigorisë kibernetike" është tërësia e rregullave, kërkesave teknike, standardeve dhe procedurave që zbatohen për certifikimin ose vlerësimin e konformitetit të produkteve, shërbimeve dhe proceseve që lidhen me sigurinë kibernetike në TIK.
102. "Skema e identifikimit elektronik" është një sistem i identifikimit elektronik, sipas të cilit mjetet e identifikimit elektronik u lëshohen personave fizikë ose juridikë apo personave fizikë, që përfaqësojnë persona të tjerë fizikë ose juridikë.
103. "Specifikim teknik" është një dokument, i cili përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti, si nivelet e cilësisë, performancës dhe sigurisë, duke përfshirë kërkesat e zbatueshme për produktin në lidhje me emrin me të cilin produkti shitet, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimi, shënjimi ose etiketimi dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit. Ky term mbulon gjithashtu metodat dhe proceset e prodhimit.
104. "Standard", sipas ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjisllacionin në fuqi për standardizimin.
105. "Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike" është një dokument politikash që përcakton objektiva, plane dhe prioritete strategjike për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit dhe krijimin e hapësirave kibernetike të sigurt për shoqërinë në nivel kombëtar.
106. "Subjektet e tjera përgjegjëse në fushën e sigorisë kibernetike" janë institucionet eprore ose rregullatore përgjegjëse për fushën e veprimtarisë së sektorëve, sipas të cilëve kategorizohen infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit.
107. "Të dhëna personale" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
108. "Të dhënat e identifikimit personal" janë një tërësi të dhënash, të cilat mundësojnë identifikimin e personit fizik ose personit juridik, apo personit fizik i cili përfaqëson personin juridik.

109. “Të dhënat e krijimit të nënshkrimit elektronik” janë të dhëna unike që përdoren nga nënshkruesi për të krijuar një nënshkrim elektronik.
110. “Të dhënat e krijimit të vulës elektronike” janë të dhëna unike, të cilat përdoren nga krijuesi i vulës elektronike për të krijuar një vulë elektronike.
111. “Të dhënat e vërtetimit të vlefshmërisë” janë të dhëna, të cilat përdoren për të vërtetuar një nënshkrim elektronik ose një vulë elektronike.
112. “Trajtimi i incidentit të sigurisë kibernetike” janë të gjitha procedurat e nevojshme për parandalimin, identifikimin, analizimin, reagimin dhe rikuperimin ndaj një incidenti të sigurisë kibernetike.
113. “Treg online” është një shërbim që përdor software, duke përfshirë një faqe interneti, pjesë të një faqeje interneti ose të një aplikacioni, i operuar nga ose në emër të një tregtari që i lejon konsumatorët të përfundojnë në distancë kontrata me tregtarë ose konsumatorë të tjerë.
114. “Vërtetim elektronik i attributeve” nënkupton një vërtetim në formë elektronike, që lejon autentifikimin e attributeve.
115. “Vërtetim elektronik i attributeve i kualifikuar” është një vërtetim elektronik i attributeve, i cili lëshohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 59 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
116. “Vërtetim elektronik i attributeve, i lëshuar nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik” është një vërtetim elektronik i attributeve, i lëshuar nga një organ i sektorit publik, që është përgjegjës për një burim autentik ose nga një organ i sektorit publik, që është caktuar si i tillë për të lëshuar vërtetime të tilla të attributeve në emër të organeve të sektorit publik, përgjegjës për burimet autentike, në përputhje me nenin 60 dhe me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
117. “Vërtetimi i vlefshmërisë” është procesi i verifikimit dhe konfirmimit të të dhënave në formë elektronike, që janë të vlefshme, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligji nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
118. “Vulë elektronike” janë të dhëna në formë elektronike, të cilat janë bashkëngjitur ose të lidhura logjikisht me të dhëna të tjera në formë elektronike, për të siguruar origjinën dhe integritetin e këtyre të fundit.
119. “Vulë elektronike e avancuar” është një vulë elektronike, e cila plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
120. “Vulë elektronike e kualifikuar” është vulë elektronike e avancuar, e cila është krijuar nga një pajisje krijimi vule elektronike të kualifikuar dhe është e bazuar në një certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike.
121. “Vulë kohore elektronike” janë të dhënat në formë elektronike, të cilat lidhin të dhëna të tjera në formë elektronike me një kohë të caktuar, që vërtetojnë se këto të dhëna kanë ekzistuar në atë kohë.
122. “Vulë kohore elektronike e kualifikuar” është vula kohore elektronike, që plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 52 të ligjit nr. 51/2026 “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”.
123. “Vulnerabilitet” është një dobësi, ndjeshmëri ose defekt i produkteve ose shërbimeve TIK, që mund të shfrytëzohet nga një kërcënim kibernetik.